

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil me gjyqtaren Naime Ahmeti, në çështjen juridike të paditëses B.M.nga P., të cilin e përfaqëson N.M., avokat nga P. sipas autorizimit në shkresa të lëndës, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve S. me seli në P., të cilën e përfaqëson L.B. -jurist sipas autorizimit, për shkak të kompensimit të dëmit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik në prani të autorizuarve të palëve ndërgjyqës me dt. 25.11.2016 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses B.M.nga P., dhe detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve S. me seli në P., që paditëses në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e datës 20.10.2011 t'ia paguaj shumën edhe atë :

Në emër të dëmit jo material:

- për dhimbje fizike për të gjitha llojet shumën prej 1.500 €,
- për shkak të frikës së përjetuar shumën prej 1.500 €,
- për shëmtim në shkallë të lehtë shumën prej 1.000

Në emër të dëmit material:

- në emër të ndihmës dhe kujdesi i huaj shuma prej 150 €,
- në emër të ushqimit të përforcuar shuma prej 75 €,
- në emër të shpenzimeve të shërimit shuma prej 278 €,

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve S. me seli në P., që shumat e gjykuara si në dispozitiv t'ia paguaj me kamatë vjetore siç e paguajnë bankat vendore për mjetet e afatizuara pa destinacion të caktuar mbi 12 muaj, duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit 25.11.2016, e deri në përmbushje definitive, së bashku me shpenzimet procedurale, në shumën prej 530.80 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes-plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

III.REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit përtej shumës së gjykuar për kompensimin e dëmit jo material dhe atë për : për shkak të dhimbjeve fizike shumën prej 1.500 €, për shkak të frikës së përjetuar shumën prej 1.000 €, dhe për dëmin material në emër të perkujdesjes së huaj shumën prej 75 €, dhe për rehabilitim klimaterik shumën 308 €, si e pabazuar.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarës së tij në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se me dt.20.10.2011, në magjistralen Mitrovicë-Prishtinë në fshatin M. ka ndodhur aksidenti i trafikut, deri të aksidenti ka ardh me fajin e të siguruarit të paditurës i cili drejtonte automjetin VW Transporter me targa të regjistrimit ..., i cili duke mos përshtatë shpejtësinë e lëvizjes së automjetit të cilin e drejtonte, për mos tu ndeshë me automjetin e cili lëvizte para tij, ka filluar tejkalimin e kolonës së automjeteve dhe me të kaluar në shiritin nga kahja e majtë, ku ishte duke lëvizur edhe automjeti të cilin e drejtonte S.Sh. me targa të regjistrimit ..., e godet me pjesën parë të automjetit, me ç'rast shkaktohen dëme materiale, ndërsa lëndime trupore pëson pasagjerja-

paditësja në cilësinë e bashkë udhëtares, e cila ishte në automjetin me targa të regjistrimit Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj të precizuar dhe ka bërë përmirësimin e kërkesë padisë sa i përket shpenzimeve të shërimit në shumë prej 278 sipas faturave të dorëzuara gjykatës në seancën shqyrtimit kryesor. Shpenzimet e procedurës kontestimore i kërkoi.

Përfaqësuesi i palës së paditur në përgjigje në padi në seancat e mbajtura dhe shqyrtimin kryesor të çështjes, e ka kontestuar pjesërisht kërkesë padinë për nga lartësia dhe për nga baza juridike, sa i përket ekspertizës mjeko ligjor ndaj të njëjtës ka pasur pjesërisht vërejtje të cilat nuk i ka paraqitur dhe nuk ka propozuar që të ftohen ekspertët për plotësim të ekspertizës, por me qëllim të përmbylljes së rastit me pajtim gjyqësor e duke u bazuar edhe në ekspertizën e censorit të kompanisë, ka ofruar ofertën në shumë prej 1.200 € për të gjitha kategoritë e dëmit material dhe jo material. Ndërsa gjykatës i ka propozuar që përtej shumës së ofruar, ta refuzoj padinë dhe kërkesë padinë e paditësit, për arsye se shumtë e kërkuar janë të larta dhe tejkalojnë arsyeshmërinë e kompensimit të dëmit duke qenë se sipas ekspertizës mjekësore janë kualifikuar si lëndime të lehta trupore. Po ashtu ka kundërshtuar kumatën e kërkuar, ndërsa te shpenzimet e procedurës kontestimore të kihet parasysh suksesi në procedurë. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i kërkoi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të dt. 25.11.2016, sipas propozimit të palëve ka administruar provat relevante dhe atë, raportin e aksidentit i përpiluar nga policia e Kosovës nr. ... i dt. 20.10.2011 së bashku me raportin e veçantë kallëzimin penal të PPK në Prishtinë si dhe skicën e vendit të ngjarjes, raportin e QKUK Qendra Emergjente në Prishtinë nr. ... i dt.20.10.2011 së bashku m dokumentacionin tjetër mjekësor si dhe faturat mbi shpenzimet e bëra për shërim, ekspertiza mjekësore e dt. 02.11.2016, aktgjykimi penal P.nr.3000/12 i dt. 12.05.2014 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, i cili nuk është i formës së prerë

Gjykata pasi bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku konform dispozitave të nenit 8 të LPK-së, erdhi në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me provat e administruara Gjykata ka gjetur se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me dt. 20.10.2011, në magjistralen Mitrovicë-Prishtinë në fshatin M. ka ndodhur aksidenti i trafikut, deri të aksidenti ka ardh me fajin e të siguarit të paditurës i cili drejtonte automjetin VW Transporter me targa të regjistrimit ..., i cili duke mos përshtatë shpejtësinë e lëvizjes së automjetit të cilin e drejtonte, për mos tu ndeshë me automjetin e cili lëvizte para tij, ka filluar tejkalimin e kolonës së automjeteve dhe me të kaluar në shiritin e kahjes së majtë, ku ishte duke lëvizur edhe automjeti të cilin e drejtonte S.Sh. me targa të regjistrimit ..., e godet m pjesën parë të automjetit, me ç'rast shkaktohen dëme materiale, ndërsa lëndime trupore pëson pasagjerja-paditësja në cilësinë e bashkë udhëtares, e cila ishte në automjetin me targa të regjistrimit Deri te kjo gjendje faktike gjykata ka ardhur duke u mbështetur në këto prova të cilat i ka pranuar si të besueshme dhe atë raportin e aksidentit përpiluar nga policia e Kosovës nr. ... i dt. 20.10.2011, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.3000/12 i dt. 12.05.2014. Fakti se i siguruari te e paditura është shkaktar i aksidentit nuk ka qenë rrethanë kontestues në mes të palëve ndërgjyqës, pra e paditura e ka pranuar bazën juridike të kërkesë padisë.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura është përgjegjëse që paditësit t'ia kompensoj dëmin gjen zbatim në dispozitat e nenit 154 dhe 178 të LMD-së.

Për të vërtetuar rrethanat se paditësja ka pësuar lëndime trupore, gjykata morri për bazë raportin e QKUK-së Qendra Emergjente në Prishtinë nr. ... i dt.20.10.2011, për paditësen dhe raportet tjera specialistike-mjekësore si dhe ekspertizën mjekësore të punuar nga ekspertët mjekësor Dr. S.D. ortoped-traumatolog dhe Dr. V.B.-psikiatër.

Ekspertët mjekësor me anë të ekspertizës pas ekzaminimeve përkatëse kanë ardh në përfundim se paditësja B.M., si pasoj e aksidentit ka pësuar lëndime trupore dhe atë, ndrydhje dhe hematoma në regjionin e dy kofsheve dhe të dy nën gjunjëve, plagë gërvishtëse në regjionin e dorës së majtë e shoqëruar me gjake derdhje nën lëkurore, ndrydhje regjionit të gjoksit. Sipas ekspertizës rezulton se natyra e lëndimeve që ka pësuar paditësja si pasoj e aksidentit klasifikohen si lëndime të lehta trupore.

Me anë të ekspertizës është vërtetuar se s paditësja si pasoj e lëndimeve ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit të rëndë 48 orë, kohë pas kohe deri në veprim të terapisë së ordinuar, dhimbje të intensiteti të mesëm 21 ditë, dhe të intensiteti të ulët vazhdon të ketë edhe tani herë pas here. Frika primare ka zgjatur disa sekonda si frikë nga vdekja pasi që paditësja ka parë aksidentin nga para, frikë sekondare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatë 12 orë si pasoj e reaksionit akut në stresë me ankth të gjeneralizuar e cila ka kaluar në frikë sekondare intensitetit të mesëm e cila ka zgjatur rreth 2 muaj e përcjellë me reagime emocionale, zgjime të shpeshta natës dhe frikës për pasoja nga aksidenti dhe frikë sekondare e intensitetit të ulët e cila ka zgjatur për 1 vit, herë pas here sidomos gjatë daljes në komunikacion, dhe dëgjimit për aksident të ngjashme. Zvogëlim i aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka.

Shëmtim trupor ka të shkallës së lehtë, në regjionin e nën gjurit të djathtë si pasoj e prerjes pas gjake derdhjes së organizuar inflamatore, në gjatësi prej 4 cm dhe gjerësi 5 mm.

Ndihma e personit të tretë nuk ka qenë e nevojshme për 14 ditë, ndërsa ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 14 ditë dhe atë i pasur me proteina, albumina vitamina dhe minerale. Rehabilitimi fizik ka qenë e nevojshme për 14 ditë brenda vitit të parë pas aksidentit.

Gjykata e ka pranuar ekspertizën mjekësore në tërësi si të besueshme, me që e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar.

Gjykata pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat e administruara që i referohen natyrës dhe pasojave të lëndimeve të pësuar nga paditësja si pasoj e aksidentit e duke marrë për bazë mendimin e ekspertëve mjeko-ligjor lidhur me lartësinë kërkesë padisë dhe për kategoritë e caktuara të dëmit jo material, gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 200 të LMD-së.

Me këtë rast, gjykata pati parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimin të cilit i shërben kompensimi i gjykuar, gjithmonë duke pas parasysh që kompensimi të jetë satisfakcion për të dëmtuarin-paditësen, duke ndikuar kështu në zbutjen pasojave negative që i janë paraqitë si pasoj e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditësit.

Gjykata pasi konstatoi rrethanat e rastit duke pas parasysh natyrën e lëndimit, shëmtimin trupor që ka pësuar paditësja si pasoj e aksidentit, i cili është në shkallë të lehtë, në regjionin e nën gjurit të djathtë si pasoj e prerjes pas gjake derdhjes së organizuar inflamatore, në gjatësi prej 4 cm dhe gjerësi 5 mm, dhimbjet e pësuar fizike, intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre, frikën e përjetuar dhe dhimbjet shpirtërore për shkak të shëmtimit, e duke marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit, praktikën e mirë gjyqësore (që i referohet lartësisë së kompensimit), vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit për pjesën e aprovuar.

Ndërsa për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ka të bëjë me dëmin jo material gjegjësisht frikën e përjetuar dhe dhimbjet fizike, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit , pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e dëmtuar dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë, dhe se lartësia e kërkesës për këto lloje të dëmit është e lartë.

Sa i përket lartësisë së kompensimit të dëmit material kjo gjykatë vendimin e vet e bazoi dhe e mbështeti në ekspertizën e ekspertëve mjeko-ligjor, provat e dorëzuara, kriterëve dhe masat për caktimin e dëmeve.

Për pjesën e refuzuar të kërkesë padisë që ndërlidhet me dëmin material që ka të bëjë me dëmin material kompensimin në emër të përkujdesjes së huaj dhe rehabilitimit klimaterik, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit duke marrë për bazë një mesatare për këtë lloj të dëmit nga 5 € në ditë për 15 ditë, pasi që nga ana e palës paditëse nuk u ofruan prova më të shumta me të cilat do të vërtetohet dëmi.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 186 dh 277 të LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës kjo gjykatë e bazoi në pajtim me dispozitat e nenit 452.1 dhe e detyroi të paditurën që paditësit të ja kompensoj shumën prej 530.80 €, edhe atë për përpilim të padisë shumën prej 78 €, për përfaqësim në dy seanca nga 101.40, për ekspertizë mjekësore shumën prej 200 €, taksë gjyqësore për padi shumën prej 25 € dhe për aktgjykim shumën prej 25 €.

Nga arsyet e theksuara më lartë është vendosur si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
C.nr.3038/11 i dt.25.11.2016

G j y q t a r j a,
Naime Ahmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së tij , Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.